



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTERRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e XII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 dhjetor 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se për momentin jemi tetë anëtarë, pasi që Ilmi Azemi ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit.

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – propozoi që të futet si pikë në të ndryshme <Subvencionimi i NPL “Përparimi” për vitin 2024 në shumë të përgjithshme 190.000.00€>.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se në rend të ditës i kemi tri raporte të Komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale. Një prej raporteve është i kompletuar me nënshkrimet e të gjithë anëtarëve të komisionit. Kurse, dy raportet tjera nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit. Nuk e di arsyen se pse ka ardhur në këtë mënyrë. Ai kërkoi nga kryesuesi i komisionit që për kuvend të kompletohen këto raporte me nënshkrimet e të gjithë anëtarëve të komisionit.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se lidhur me propozimin për subvencionim të NPL “Përparimi” është biseduar edhe në mbledhjen e kuvendit kur iu kanë ndarë 60 mijë euro se ideja ka qenë që t’iu ndahen edhe 190 mijë euro që të subvencionohen me 250 mijë euro për shkak se nga 1 janari do ta marrin menaxhimin e mbeturinave. Edhe një propozim tjetër është për lirim nga taksa për shfrytëzimin e hapësirës publike. Është dashur që këto propozime t’iu vijnë me kohë, por kërkoj mirëkuptimin tuaj që t’i mbështesni këto dy propozime.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – theksoi se kanë pasur vullnetin që ta mbështesin çdo herë kompaninë “Përparimi”. Ne e kemi parë kaosin që ka ndodhur dhe në qytet, sa i përket baltës, ku edhe ti si kryetar ke dal dhe i ke vizituar duke bërë pastrimin. Ndërmarrja “Përparimi” është ajo që prodhon më së shumti baltë në qytetin e Vushtrrisë. Gjendja në oborrin e kompanisë është e tmerrshme nga balta. Nëse një kompani nuk mund ta

mirëmbajtje shtëpinë e vet, atëherë ku kemi guxim që t'ua japim qytetin dhe fshatrat që t'i mirëmbajnë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se NPL “Përparimi” nuk është kompani që shtron rrugë. Faji është i yni, sepse iu kam thënë që duhet të rregullohet objekti ku gjenden zyret e kompanisë, sepse po bartet balta prej aty. Prandaj, ne e kemi bërë projektin edhe për rregullimin e zyrës. Ai tha që tenderi për zhavor u shty që 9 muaj, duke u ankuar operatorët ekonomik në OSHP dhe kemi mbetur keq pa u mirëmbajtë rrugët me zhavor. Idrizi tha se një pjesë të baltës në rrugë po e bartin edhe kompanitë e ndërtimit, siç është rasti me rregullimin e sheshit.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se nuk kemi arsyetim për këto pika që u propozuan në të ndryshme. Edhe para kësaj here nuk e kemi përkrahur subvencionin për NPL “Përparimi” dhe koha tregoi që kemi vepruar drejt. Kjo për shkak se nuk kemi pasur një raport me kohë nga komisioni i aksionarëve i kësaj ndërmarrjeje. E kemi parë një raport skandaloz që e kemi trajtuar në seancën e kaluar, ku e kemi pasur të bashkëngjitur raportin e auditimit për vitin 2021, kurse raportimi është bërë për vitin 2022. Në të njëjtën situatë jemi edhe tani, ku kjo ndërmarrje po kërkon mjete financiare, ku nuk kemi asnjë arsyetim se ku do të destinohen këto mjete. Pra, e njëjta kompani nuk ka sjellë raport për mjetet që i janë ndarë nga kuvendi. Pra, po kërkoj përsëri që të na vjen një raport për shpenzimin e këtyre mjeteve. Ai tha se po flitet për blerje të makinerisë së amortizuar totalisht, ku janë paguar 69 mijë euro për një kamion të vitit 1999. Prandaj, me NPL “Përparimin” duhet të merret dikush tjetër, sepse ka shkelje flagrante.

Ne do të votojmë kundër që të procedohet për kuvend dhe kemi arsye bindëse për një gjë të tillë, sepse në asnjë rast kjo ndërmarrje nuk po tregon seriozitet.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tri (3) vota “për”, katër (4) “kundër”, një (1) “abstenim” nuk rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim: <Subvencionimi i NPL “Përparimi” për vitin 2024 në shumë të përgjithshme 190.000.00€>.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim <Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit>.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.11.2023;
2. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;
3. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale për ZK – Gracë;
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale për ZK – Vushtri;
6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale të pronave bujqësore dhe lokaleve afariste;
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit;
8. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.11.2023.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se në procesverbal nuk po shkruhen të gjitha diskutimet e antëatëve. Edhe më herët ka pasur raste kur nuk janë cekur, por i kemi mirëkuptuar për shkak të ngarkesës. Por, kjo nuk bën të krijohet si praktikë që mos të ceken në procesverbal diskutimet e anëtarëve.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – dua të ju njoftojë që nuk është për shkak të ngarkesës, por në mbledhjen e fundit ka qenë një problem teknik, ku mungon një pjesë e incizimit. Bujari ka bërë përpjekje me nxjerr esencën në bazë të shënimeve që ka marrë për atë që është diskutuar. Prandaj, është bërë një shkëputje për shkak të një problemi teknik.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “kundër” aprovoi procesverbalin e datës 16.11.2023.

2. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se kuvendi ka themeluar një komision, i cili ka punuar për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024. Drafti i ri ka pak ndryshime, ku ne si komision kemi propozuar që drejtoritë ta informojnë kuvendin për punën e tyre çdo gjashtë muaj (janar – korrik). Në bazë të praktikës së mëhershme, duhet të lirohen nga ky gjashtëmujor: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim, për shkak se raportojnë në mënyrë periodike në kuvend. Prandaj, në bashkëpunim me drejtoritë i përcaktojmë edhe afatet e raportimit. Ndryshim tjetër është se Raporti i Komitetit për Komunitete të zhvendoset nga janari në muajin shkurt. Pastaj, formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës e kemi bartur nga muaji mars në shkurt, me qëllim që të përshpejtohen procedurat dhe të vihen sa më shpejt mjetet në shërbim të studentëve dhe nxënësve.

Po ashtu, Informatën për ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë dhe Raportin për punën e NPL “Përparimi” në Vushtri për vitin 2023 e kemi bartur nga muaji prill në mars. Informata për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2024/2025 ka qenë e planifikuar në tetor, e kemi zhvendosur në nëntor për shkak

se deri në fund të muajit nëntor ka riprovime. E kemi menduar që në fund të muajit dhjetor të kemi një informatë nga Njësia e Zjarrfikësve.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në muajin mars <Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrisë> duhet të ceket periudha kohore, pra për vitin 2023.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – edhe unë pajtohem që tek informata për ndërtimet të specifikohet që të jetë për vitin 2023. Po ashtu, informata le të jetë në përgjithësi dhe jo vetëm për ndërtimet, por edhe për fushat tjera.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – propozoi që të futet si pikë e re, <Raport për procedurat e lejeve ndërtimore për vitin 2023 nga Drejtoria për Urbanizëm>.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kërkojmë që në muajin shkurt 2024, Drejtoria e Urbanizmit të na e sjell një informatë vjetore lidhur me procesin e dhënies së lejeve ndërtimore në Komunën e Vushtrisë për vitin 2023.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – edhe një çështje tjetër e kemi diskutuar me komisionin, por nuk e kemi vendosur në plan. Kemi dhënë si propozim që para aprovimit të buxhetit, si kuvend të shkojmë në Shqipëri apo diku tjetër jashtë vendit dhe ta diskutojmë bashkërisht draftin e buxhetit. A jeni dakord që ta planifikojmë në fillim të shtatorit një vizitë jashtë vendit për ta diskutuar draftin e buxhetit?

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në parim pajtohem që ta kemi një vizitë të tillë në mënyrë që ta diskutojmë draftin e buxhetit, por se nuk ka nevojë që të jetë në plan.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale për ZK – Gracë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se e përgëzon komisionin për hulumtimin detaj që e ka bërë edhe për këtë pikë, por edhe për dy pikat tjera. Dy raportet tjera kanë ardhë me vonesë dhe nuk kemi pasur kohë që t'i analizojmë, por për kuvend do t'i trajtojmë më detajisht, në mënyrë që ta shohim se si qëndron gjendja lidhur me shfrytëzimin e pronave komunale në Komunën e Vushtrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale për ZK – Vushtri.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – nga kjo që e kemi parë, shumica e shfrytëzuesve të pronave komunale janë në obligime ndaj komunës ose u ka skaduar kontrata. Është dashur që edhe Drejtoria për Inspektime të na sjell një informatë që ta shohim se a ka ndërmarrë ndonjë hap që t'i lirojë pronat atyre që iu ka skaduar kontrata.

Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit – atë që Sylejmani e potencoi se a ka marrë ndonjë veprim Drejtoria për Inspektime, dua ta sqaroj se Drejtoria për Inspektime nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, për shkak se prej që është formuar komisioni, fillimisht është dashur të bëhet verifikimi i këtyre çështjeve, pastaj qysh të vendos kuvendi, të merren edhe masa nga drejtoritë përkatëse. Nuk dua ta shfaqësojë askënd, por ka pasur shumë kontrata në dy apo tri drejtori. Si komision është dashur së paku katër apo pesë muaj t'i grumbullojmë të dhënat. Një pjesë e kontratave ka qenë në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, një pjesë e kontratave ka qenë në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, një pjesë të Zyra e Kryetarit.

Ai sqaroi se provat për dy raportet nuk janë bashkëngjitur, për shkak se do të bëhej një material voluminoz. Prandaj, ne si komision i kemi provat dhe kushdo që është i interesuar mund ta kërkoj.

Ai tha se këtu e kemi një provë, ku më datë 18.11.2019, menaxheri i kontratave e ka informuar ish-drejtorin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, Adnan Lahun dhe ish-Kryetarin e Komunës, Xhafer Tahirin për skadimin e kontratave dhe se nuk kanë marrë as edhe një veprim.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se nuk janë pa informata, sepse menaxheri i kontratave e ka për obligim ta përcjell skadimin e kontratave dhe përmbushjen e kushteve. Përtej kësaj, ne kemi një Zyrë Ligjore dhe një avokat privat që po paguhet nga komuna, ku këto lëndë është dashur me qenë bazë për ta. Prandaj, komuna duhet t'ju kërkoj fillimisht pagesën e borxheve, shfrytëzuesve të pronës komunale. Nëse ata nuk përgjigjen, atëherë duhet të ngritet padi ndaj tyre për dëmet që ia kanë shkaktuar komunës.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – deklaroi se në nëntor të vitit 2019 qenkan njoftuar ish-kryetari i komunës dhe ish-drejtori i Kadastrit, prandaj kjo nuk është në rregull që nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Shtrohet pyetja se menaxheri i kontratës a e ka njoftuar kryetarin aktual dhe drejtorin e tanishëm për një gjë të tillë?

Tek kontrata nr.17 qenka bërë një lëshim tek mbiemri i qiramarrësit Rrezarta Bajrami, kurse nuk iu ka përmendur mbiemri Hasani, ashtu siç është në kontratë Rrezarta Bajrami Hasani. Ai kërkoi që të bëhet ky përmirësim.

Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit – në cilësinë e kryesuesit kam kërkuar informata lidhur me atë që e tha anëtari i kuvendit. Kryetari i komunës e kishte themeluar një komision nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë. Por, në momentin që është themeluar ai komision, ne si komision i kuvendit veç kemi qenë funksional. Iu kam sugjeruar që dy komisione për të njëjtën çështje nuk është në rregull me qenë. Prandaj, ata kanë pushuar së vepruari dhe e kanë pritur raportin e komisionit tonë.

Lidhur me atë që e tha Sylejmani që komuna të kërkoj pagesën e borxheve, këto i kemi paraqitur si rekomandime në raportin për toka bujqësore. Kurse, tek raporti për kiosqe, i vetmi rekomandim është shkëputja e njëanshme e kontratës dhe listimi i pronave. Kjo për shkak se ka kaluar skadimi i afatit të kontratës mbi tri vite dhe lëndët janë parashkruar. Prandaj, duhet konsultuar Zyra Ligjore për një gjë të tillë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se duhet të gjendet mënyra për marrjen e borxhit. Unë mendoj që kontrata nuk parashkruhet dhe se deri në ditën që ka pasur kontratë, gjykata duhet ta obligojë që t'ja paguajë borxhin komunës për shfrytëzimin e pronës komunale. Kurse, që nga momenti i skadimit të kontratës e deri sot që nuk janë ndërmarrë veprime, mendoj që është bërë keqpërdorim i detyrës zyrtare me ose pa qëllim, sepse është dëmtuar rëndë interesi i komunës.

Bekim Zabërgja, kryesues i komisionit – Lidhur me çështjen e nënshkrimit të anëtarëve të komisionit në raport, ai tha se vetëm kryesuesi i komisionit e nënshkruan raportin. Unë si kryesues e kam kryer punën time, dhe nuk e shtoj asnjë pikë dhe asnjë presje në raport.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se është çështje e komisionit se si e sjell në kuvend, por po e jap mendimin tim personal se ky komision ka bërë një punë të jashtëzakonshme, prandaj po kërkoj që për kuvend të na vjen me të gjitha nënshkrimet e anëtarëve të komisionit.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet me nënshkrimet e të gjithë anëtarëve të komisionit dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit lidhur me shfrytëzimin e Pronës Komunale të pronave bujqësore dhe lokaleve afariste.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – deklaroi se pasqyra e këtij raporti tregon më së miri atë për çka ishin të kënaqur drejtori dhe asambilisti, i cili është bërë drejtor për inkasimin e të hyrave, ku për 11 muaj ishin inkasuar vetëm 17 mijë euro.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se nëse ka mundësi komisioni ta siguroj si informatë që deri në seancë ta verifikoj se përfituesit e këtyre pronave bujqësore, a janë përfitues të subvencioneve njëkohësisht nga qeveria, me të njëjtat prona dhe me kontrata të skaduara.

Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – deklaroi se Ministria e Bujqësisë e ka ndryshuar mënyrën e ndarjes së subvencioneve, tash e jep vetëm emrin dhe mbiemrin me deklaratë nën betim dhe e bën digjitalizimin e parcelës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se është mirë Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ta bëjë verifikimin e asaj çështje që e ceka më lart, sepse përmes deklaratës nën betim që e ceku drejtori, ai mund edhe ta gënjej institucionin për të përfituar.

Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – tha se subvencionet ndahen nga Qeveria dhe ne nuk kemi të drejtë ta pyesim e kujt është toka. Ai përmes deklaratës nën betim i deklaroi pronat.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit.

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se po ju njoftoj me kërkesën e Postës së Kosovës, e cila ka kërkuar shfrytëzimin e hapësirës publike brenda objektit të komunës për ofrimin e shërbimeve postare. Duke pasur parasysh që legjislacioni në fuqi nuk e trajton shfrytëzimin e hapësirës publike brenda objekteve dhe nuk ka kod buxhetor për ta trajtuar këtë çështje. Prandaj, edhe sipas kërkesës së tyre kemi sjell propozimin për lirim të pagesës së taksës për shfrytëzimin e hapësirës publike në hollin hyrës (korridorin qendror) të Komunës për më pak se një vit.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – nëse posta merr provizion, nuk jam i pajtimit që t'i lirojmë nga taksa. Prandaj, ai kërkoi që t'i vendoset një taksë për shfrytëzim të hapësirës publike.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se nuk e dimë çfarë shërbimesh do të kryejë posta, kur shumë pagesa kryhen brenda komunës.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se fillimisht duhet të bëhet kontrata për dhënie në shfrytëzim, pastaj të merret vendimi për lirim. Prandaj, nuk mund të merret vendimi për lirim, pa e jep kontratën.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – nëse postën e lirojmë nga pagesa e taksës, atëherë është padrejtësi dhe diskriminim ndaj institucioneve tjera financiare që bëjnë pagesa.

Mentor Hasani, anëtar i KPF-së – e dimë që është një lehtësim për qytetarët nëse u lejojmë që pagesat të kryhen brenda objektit, si dhe sa e di edhe provizioni është më i vogël në krahasim me kompanitë private, por duhet të shikohet se me çfarë kushtesh është vendosur në objektin e Ministrisë së Punëve të Brendshme – në Vushtrri. Nëse janë aty të liruar nga pagesa edhe ne veprojmë njëjtë. Nëse nuk është e liruar nga taksa aty, pse ne ta lirojmë, kur bëhet fjalë për të njëjtën kompani, qyteti i njëjtë.

Fortuna Krasniqi Spahiu , drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se deri në seancë ne po hulumtojmë se si është gjendja në institucionet tjera dhe për kuvend mund të vijmë me një propozim.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që pas hulumtimit në institucionet tjera dhe me informacione shtesë të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së